



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:063886

Datë: 14.11.2022

Numri i dokumentit: 03638017

P.nr.1021/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.Sh nga... Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe të akuzuarit A.M nga.. Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.452/2022 të datës 30.03.2022, jashtë seance dhe sipas detyrës zyrtare me datë 14.11.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër ND.nr. 91/2022 e datës 08.11.2022, e lidhur në mes të akuzuarve N.Sh dhe A.M që të dy nga Komuna e Gjilanit.
- II. HEDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.452/2022 e datës 30.03.2022 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit N.Sh nga Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe të akuzuarit A.M nga..., Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-ës ngase të akuzuarit kanë arritur marrëveshje mes tyre për ndërmjetësim.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan- Departamenti i Përgjithshëm me datë 31.03.2022 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.452/2022 kundër të kundër të akuzuarit N.Sh nga ..Komuna e Gjiilanit për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe të akuzuarit A.M nga ..Komuna e Gjiilanit për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.11.2022 që të dy të akuzuarit një zëri i kanë propozuar gjykatës kjo çështje të referohet në procedurën e ndërmjetësimit meqenëse plotësohen kushtet ligjore për një gjë të tillë, propozim ky i cili nuk është kundërshtuar as nga prokurori i shtetit me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim dhe këtë çështje e ka referuar në procedurën e ndërmjetimit me ç'rast me datë 08.11.2022 pranë zyrës për ndërmjetësim në këtë gjykatë është arritur marrëveshja me numër ND.nr.91/2022 sipas të cilës të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë secili prej tyre veç e veç për veprat penale të cilat i vihen në barrë, njëkohësisht i kanë kërkuar falje njëri tjetrit, i kanë rregulluar raportet mes tyre si dhe kanë premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla.

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat si dhe në bazë të nenit 358 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së dhe nenit 2, 4, 8, 14, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1021/2022 me datë 14.11.2022

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.